



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.156

26 nëntor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.798, datë 29.9.2010	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e mbetjeve spitalore”	8209
Vendim i KM nr.850, datë 21.10.2010	Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve	8221
Vendim i KM nr.851, datë 21.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Librazhdit.....	8222
Vendim i KM nr.852, datë 21.10.2010	Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit	8223
Vendim i KM nr.854, datë 21.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Fushë-Arrës”.....	8224
Udhëzim i KM nr.7, datë 10.11.2010	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.6, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”	8227

Udhëzim i MASH nr.22, datë 29.7.2010	Për emërimet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar	8228
Udhëzim i MASH nr.28, datë 10.9.2010	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2010-2011..	8229
Udhëzim i MASH nr.29, datë 5.10.2010	Për strukturën e vitit akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë dhe masat që duhen marrë për zbatimin e saj	8233
Udhëzim i MASH nr.30, datë 6.10.2010	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.28, datë 10.9.2010 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011.	8234
Udhëzim i MASH nr.31, datë 11.10.2010	Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011.....	8235
Udhëzim i MASH nr.32, datë 21.10.2010	Për regjistrimin e kandidatëve fitues në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për plotësimin e kuotave të porealizuara, për vitin akademik 2010-2011	8236
Urdhër i MASH nr.460, datë 11.10.2010	Për shpërndarjen e kuotave të pranimit për një program të dytë studimi dhe të kuotave për transferim studimesh, në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011.....	8238

VENDIM
Nr.798, datë 29.9.2010

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 3 e 4 të nenit 42 të ligjit nr.10 138, datë 11.5.2009 “Për shëndetin publik”, të nenit 3 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” dhe të neneve 26 e 27 të ligjit nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë dhe organet e njëjste të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi dhe objekti

Kjo rregullore përcakton procedurat, rregullat dhe standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit.

2. Përkufizime të termave

Në kuptimin e kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Mbetje spitalore” janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”.

b) “Prodhues i mbetjes” është personi fizik dhe juridik, i cili zotëron ose administron një institucion shëndetësor, që krijon mbetje spitalore, duke përfshirë dhe duke mos u kufizuar vetëm në: spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, klinika dentare, laboratorë dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik, institucionet kërkimore-shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare, shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

c) “Zotërues i mbetjes spitalore” është personi fizik e juridik, i cili krijon mbetje spitalore, grumbullon, ruan përkohësisht, transporton dhe largon për në vendin e caktuar mbetjet spitalore të prodhuara prej tij, si dhe i përpunon e i asgjëson ato.

d) “Transport” është veprimtaria që lidhet me transportin e mbetjeve spitalore, duke përfshirë ngarkimin, transportimin e shkarkimin, sikurse dhe përgatitja, shërbimi e mirëmbajtja e pajisjeve të përdorura për transportin e mbetjeve spitalore.

e) “Institucion shëndetësor” është çdo vend ku krijohen mbetjet spitalore, duke përfshirë: spitale, poliklinika, qendrat shëndetësore, kabinete mjekësore, qendra mjekësore, kabinete dentare, klinika dentare, laboratorë dentarë, qendra diagnostike, depo farmaceutike, farmacitë, qendra kozmetike, qendra të tatuazhit, qendra të rehabilitimit nga droga, laboratorët e shëndetit publik,

institucionet kërkimore shkencore, banka e gjakut, morget, shërbimet funerale, klinikat veterinare, shërbimet ambulatorë të infermierisë që vizitojnë pacientë në banesa.

f) “Instrumente të mprehta” janë të gjitha sendet e infektuara apo të painfektuara që mund të shkaktojnë shpime apo prerje, duke përfshirë, dhe mos u kufizuar, vetëm tek aget, shiringat, bisturitë, lamat, gërshërët, tubat kapilarë dhe instrumentet e tjera të mprehta.

g) “Mbetje infektuese” janë të gjitha mbeturinat e ndotura nga çdo lloj patogjeni, si: bakteret, viruset, parazitët ose kërpudhat dhe përfshijnë kulturat nga puna në laborator, mbeturinat nga ndërhyrjet kirurgjikale dhe autopsitë, mbeturinat nga pacientët e infektuar, materialet apo pajisjet (që janë për t’u hedhur) në kontakt me këta pacientë, me kafshë të infektuara, si dhe materialet dhe pajisjet e mjekëve dhe të personelit tjetër, që kanë qenë në kontakt me pacientë të infektuar.

h) “Mbetje patologjike” përfshijnë indet, organet, pjesë të trupit, placentat, gjakun dhe lëngjet e tjera të organizmit të njeriut.

i) “Mbetje farmaceutike” përfshijnë produktet farmaceutike të skaduara ose të papërdorshme, produktet farmaceutike të kontaminuara nga rënia/rrëzimi përtokë, barnat e tepërta, vaksinat ose serumet dhe sendet e hedhura të përdorura gjatë trajtimit të barnave, të tilla si: shishe, kuti, doreza, maska, tuba ose shishe.

j) “Mbetje radioaktive” përfshijnë mbeturinat e lëngëta, të ngurta dhe të gazta, të ndotura me lëndë radioaktive, të prodhuara nga analizat “*in vitro*” të indeve dhe lëngjeve të trupit, si dhe nga imazheria “*in vivo*” e organeve të ndryshme për qëllime diagnostike dhe terapeutike.

k) “Mbetje e rrezikshme” përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar.

l) “Mbetje të parrezikshme” përfshijnë letrat, sendet prej qelqi, plastike, kartonët, ambalazhet, mbeturinat ushqimore, mbeturina druri dhe ndërtimi.

m) “Administrimi i mbetjeve” përfshin minimizimin/reduktimin në burim, ndarjen, grumbullimin, transportimin, depozitimin, asgjësimin, pakësimin dhe ripërdorimin e mbetjeve.

n) “Magazinin” është grumbullimi i përkohshëm në një vend të caktuar i mbetjeve spitalore sipas kërkesave të paragrafit 8.5 të kësaj rregulloreje.

o) “Asgjësim i mbetjes” përfshin proceset e eliminimit të rrezikshmërisë dhe që pas të cilave nuk parashikohet përpunim tjetër i mbetjes.

p) “Trajtim i mbetjes” është ndryshimi i vetive ose i përbërjes së mbetjes, duke e transformuar atë në produkt përfundimtar ose në lëndë të parë apo ndihmëse për prodhimin e produkteve përfundimtare.

q) “Qese/çantë kundër rreziqeve kimike” nënkupton një qese/çantë, e cila nuk fut lagështirën dhe ka forcë të mjaftueshme për të mos u çarë, grisur ose për të mos plasur në kushte normale përdorimi të thesit me plehra.

3. Fusha e veprimit

Kjo rregullore zbatohet nga të gjithë personat fizikë e juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj:

- veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje spitalore;

- kur janë zotërues të mbetjeve, të licencuar për grumbullimin, ruajtjen, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore.

Përfshihen nga zbatimi i kësaj rregulloreje:

Individët prodhues të mbetjeve spitalore, kur këto prodhohen gjatë vetëmjekimit ose gjatë shërbimit mjekësor në banesë, përveçse kur individit detyrohet t’i vendosë mjetet e mprehta në kontejnerë rezistentë ndaj shpimeve dhe t’i largojë ato në përputhje me rregullat e miratuara nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Shëndetësisë.

4. Roli i organeve shtetërore

a) Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë hartojnë standardet e administrimit të mbetjeve spitalore.

b) Ministria e Shëndetësisë siguron kushte për aplikimin e standardeve të administrimit të mbetjeve spitalore.

c) Inspektorati i Mjedisit dhe Inspektorati Sanitar Shtetëror janë përgjegjës për kontrollin e zbatimit të standardeve për menaxhimin e mbetjeve spitalore.

d) Organet e pushtetit vendor janë përgjegjëse për miratimin e vendndodhjes së impianteve të përpunimit të mbetjeve spitalore dhe venddepozitimit të mbetjeve spitalore jo të rrezikshme.

e) Organet e pushtetit vendor monitorojnë administrimin e mbetjeve spitalore sipas kompetencave.

KREU II DETYRIMET E PRODHUESVE TË MBETJEVE SPITALORE

5. Prodhuesit e mbetjeve spitalore janë përgjegjës për:

a) grumbullimin e kontrolluar të mbetjeve spitalore pranë institucionit shëndetësor;

b) ndarjen e mbetjeve spitalore të parrezikshme (të llojit urban) nga mbetjet spitalore të rrezikshme;

c) ambalazhimin, etiketimin, magazinimin, grumbullimin, trajtimin, transportimin dhe asgjësimin në mënyrë të përshtatshme, të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre;

d) shpenzimet e transportit, asgjësimit ose riciklimit të mbetjeve spitalore të gjeneruara prej tyre. Kjo përgjegjësi është e pashmangshme dhe e pavarur nga përgjegjësia e ndonjë personi të tretë të ngarkuar nga prodhuesi, për të ndërmarrë këto veprimtari;

e) të gjitha dëmet e shkaktuara në mënyrë direkte ose indirekte në mjedis dhe në shëndetin publik nga procesi i grumbullimit, magazinimit, transportimit dhe asgjësimit të mbetjeve spitalore të krijuara prej tyre.

6. Regjistrimi

6.1 Çdo prodhues i mbetjeve spitalore duhet të regjistrohet në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, ndërsa prodhuesit që fillojnë veprimtarinë e tyre, pas botimit të saj në Fletoren Zyrtare, jo më vonë se 30 ditë para fillimit të veprimtarisë që krijon mbetje spitalore.

6.2 Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave vendos një numër regjistrimi për çdo prodhues të mbetjeve spitalore, i cili i njoftohet prodhuesit.

6.3 Çdo prodhues duhet të vendosë numrin e regjistrimit mbi të gjitha fletët shoqëruese, etiketat e vendosura në ambalazhimet që mbajnë mbetje spitalore dhe skedat bashkëngjitur ngarkesave që përmbajnë mbetje spitalore.

6.4 Numri i regjistrimit është individual dhe nuk mund të transferohet.

6.5 Për prodhuesit e regjistruar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, kjo ministri brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, harton një data-bazë, ku përfshihen të dhënat e plota të regjistrimit të mëparshëm dhe nëse rezulton se të dhënat e regjistruara nuk janë të plotësuara në përputhje me këtë rregullore, i njofton prodhuesve të mbetjeve spitalore për detyrimin e plotësimit të të dhënave që mungojnë. Ky proces duhet të përfundohet brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, në rast përshihen edhe prodhuesit e regjistruar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, që nuk plotësojnë detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore sipas afateve të parashikuara në të.

6.6 Çdo prodhues duhet të njoftojë me shkrim Ministrinë, brenda 30 ditësh, për ndryshimet në strukturën e pronësisë, emërtimin, vendndodhjen, mënyrën e veprimtarisë ose për ndonjë ndryshim në veprimtarinë e tij, që mund të ketë ndikim në llojin dhe sasinë e mbetjeve spitalore të krijuara.

7. Masat konkrete për administrimin e mbetjeve spitalore

Brenda gjashtë muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo prodhues mbetjesh spitalore përgatit:

7.1 Një rregullore të brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore brenda njësisë funksionuese.

7.2 Një plan për administrimin e mbetjeve spitalore, që duhet të përmbajë minimalisht informacionin e mëposhtëm:

- a) një përshkrim të mbetjeve spitalore të prodhuara nga njësia përkatëse, duke përfshirë llojin, peshën dhe vëllimin;
- b) një përshkrim të procedurave të kërkuara për administrimin e mbetjeve në njësinë përkatëse;
- c) një përshkrim të zonës brenda dhe jashtë saj, ku prodhohet depozitohet apo trajtohet mbetja spitalore;
- d) destinacionin, metodat e trajtimit dhe të asgjësimit për çdo lloj mbetje spitalore;
- e) procedurat dhe veprimtaritë për kualifikime në administrimin e mbetjeve spitalore;
- f) veprimtaritë informative që lidhen me shëndetin, sigurinë dhe asgjësimin e rregullt të mbetjeve spitalore për të gjithë personat që mund të bien në kontakt me to;
- g) procedurat dhe pajisjet e kontrollit të ndotjes dhe të pastrimit;
- h) emrin, adresën dhe numrin e telefonit të personit (personave) përgjegjës për administrimin e mbetjeve spitalore.

7.3 Çdo prodhues rishikon planin për administrimin e mbetjeve spitalore në përputhje me planin kombëtar për administrimin e mbetjeve të ngurta dhe planin kombëtar për administrimin e mbetjeve të rrezikshme, brenda një viti pas miratimit të tyre.

7.4 Plani për administrimin e mbetjeve spitalore duhet të përditësohet çdo tre vjet.

KREU III TRAJTIMI I MBETJEVE SPITALORE

8. Çdo prodhues i mbetjeve spitalore është përgjegjës për trajtimin e mbetjeve që nga prodhimi, grumbullimi, ndarja, transporti, magazinimi, përpunimi dhe deri tek asgjësimi i tyre.

8.1 Çdo prodhues ndan që në burim elementet e rrezikshme nga ato të parrezikshme të mbetjeve spitalore, sipas rregullores së brendshme për administrimin e mbetjeve spitalore dhe i magazinon ato të ndara.

8.2 Në rast se në vendin e prodhimit apo gjatë transportit, mbetjet spitalore të rrezikshme, në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme, përzihen me mbetje spitalore të parrezikshme, këto mbetje spitalore do të trajtohen si mbetje të rrezikshme.

8.3 Pas procesit të ndarjes, për mbetjet spitalore të parrezikshme që cilësohen si “mbetje urbane” nga paragrafi 9 i nenit 2 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, zbatohet ligji nr.8094, datë 21.3.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”.

8.4 Mbetjet spitalore të rrezikshme ambalazhohen dhe etiketohen në përputhje me shtojcën 2.A dhe magazinohen të ndara nga mbetjet e tjera.

8.5 Kur mbetjet spitalore duhet të transportohen për t’u trajtuar në vend tjetër, magazinimi në terren i tyre bëhet në një zonë të caktuar në brendësi apo në afërsi të vendeve të trajtimit, apo të pikave të nisjes, duke përmbushur kërkesat e mëposhtme:

- a) Të lejohet hyrja vetëm e personave që kanë kualifikim për të administruar mbetje spitalore.
- b) Të tregohet kujdes për sigurinë e kontejnerëve, të parandalohen rrjedhjet, të sigurohet mbrojtja nga uji, shiu dhe era, si dhe të shmangen kushtet e inkubimit mikrobik dhe/ose të dekompozimit të tyre. Mbetjet njerëzore, shtazore apo të ndonjë gjallesë tjetër të magazinuar për më shumë se 24 orë, por gjithsesi më pak se 48 orë nga ambalazhimi, duhet të ruhen në frigorifer ose hapësirë frigoriferike që përdoret vetëm për mbetjet spitalore në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.
- c) Të jenë ndërtuar me materiale të qëndrueshme dhe pa kënde, që pastrohen lehtësisht, që nuk lejojnë depërtimin e lëngjeve dhe të jenë rezistentë ndaj parazitëve e agentëve të tjerë mjedisorë.
- d) Të mbahen pastër në kushte të mira sanitare dhe në gjendje të mirë funksionale.
- e) Mbetjet të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme me simbolin ndërkombëtar të biorrezikshmërisë të paraqitur në shtojcën 2.A dhe me njoftime të rrezikut në dyer, porta ose mbulesa, frigoriferë dhe kontejnerë të tjerë që tregojnë përdorimin e magazinës për mbetje spitalore, ku hyrja e personave të paautorizuar është e ndaluar.

f) Sistemet e kullimit të dyshemesë së magazinës duhet të mundësojnë shkarkimet direkt në një sistem kanalizimesh sanitare për asgjësimin e ujërave të ndotura, në përputhje me ligjin nr. 9115, datë 24.7.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, ose në një impiant grumbullimi që parandalon derdhjen e lëngjeve dhe rënien në kontakt me mjedisin.

8.6 Kontejnerët e mbetjeve të rrezikshme spitalore duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të etiketohen në përputhje me shtojcën 2.B dhe të magazinohen në mënyrë të tillë që të lejojnë hyrjen për qëllime inspektimi.

8.7 Mbetjet spitalore nuk duhet të presohen apo t’u nënshtrohen veprimeve të sforcuara mekanike, përveç rasteve kur këto janë pjesë e një procesi të posaçëm trajtimi, të miratuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, bazuar në ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”. Mbetjet e rrezikshme spitalore transportohen brenda 45 ditësh nga grumbullimi i tyre.

8.8 Transportimi në terren i mbetjeve të rrezikshme spitalore kryhet në përputhje me:

a) Mbetjet spitalore që krijohen jashtë zonës së prodhimit fillestar të tyre, nuk pranohen për transport në terren.

b) Asnjë person nuk duhet të pranojë për transport mbetjet spitalore që nuk janë ambalazhuar dhe etiketuar në përputhje me shtojcën 2.

c) Një automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të përmbushë kërkesat e shtojcës 4 të kësaj rregulloreje.

8.9 Magazinimi i mbetjeve spitalore. Mbetjet infektive nuk duhet të magazinohen për më shumë se 45 ditë para trajtimit. Në qoftë se era përbën shqetësim publik, Inspektorati Sanitar Shtetëror/Inspektorati i Mjedisit kërkon largim më të shpeshtë. Në zonën e magazinimit të kontejnerëve me mbetje mjekësore duhet të ndalohet hyrja e personave të paautorizuar. Zonat e magazinimit duhet të kenë shenja paralajmëruese në dyert hyrëse, porta ose kapakë. Në zonën e magazinimit nuk duhet të lejohet hyrja e kafshëve dhe elementeve natyrore dhe të parandalohet krijimi i vendeve të shumimit ose burimit të ushqimit për brejtësit ose insektet. Ato, gjithashtu, duhet të jenë të rrethuara.

8.10 Përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhet me metodat sipas shtojcës 3.

8.11 Impiantet për përpunimin e mbetjeve spitalore respektojnë kushtet e asgjësimit dhe normat e shkarkimeve në ajër të përcaktuara në pikën 5.1.2 “Linja për djegien e mbetjeve të rrezikshme dhe spitalore” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”, si dhe kërkesat specifike sipas shtojcës 5.

8.12 Impianti për trajtimin ose asgjësimin e mbetjeve spitalore nuk duhet të pranojë nga prodhuesit mbetje spitalore në rast se nuk janë shoqëruar me fletë-dorëzimi, në përputhje me ligjin nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

8.13 Impianti duhet të mbajë regjistrime të pranimeve, që minimalisht përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe adresën e prodhuesit;

b) peshën e mbetjeve të pranuar;

c) datën dhe orën e pranimit të mbetjeve; dhe

d) nënshkrimin e personit që pranon mbetjet.

8.14 Të gjitha regjistrimet që bëhen sipas kësaj rregulloreje, ruhen për një periudhë deri në shtatë vjet. Kjo periudhë shtyhet automatikisht në rast të moszbatimit të aktit administrativ për veprimtarinë e rregulluar, ose me kërkesën e Ministrisë të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

9. Instalimi i impianteve

Përcaktimi i vendit ku instalohen impiantet e përpunimit dhe të asgjësimit të mbetjeve spitalore, i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas përcaktimeve të neneve 12 dhe 13 të ligjit nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

KREU IV LEJA MJEDISORE DHE AKTMIRATIMI HIGJIENO-SANITAR

10.1 Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

10.2 Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

10.3 Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.

KREU V MONITORIMI I ADMINISTRIMIT TË MBETJEVE SPITALORE

11. Detyrimi për monitorimin e administrimit të mbetjeve spitalore

11.1 Monitorimi i mbetjeve spitalore është pjesë e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit dhe kryhet sipas kërkesave të tij. Monitorimi i mbetjeve spitalore përfshin të gjitha fazat procesit të administrimit të tyre, sipas kësaj rregulloreje, dhe realizohet i veçantë për çdo lloj mbetjeje spitalore.

11.2 Ministri i Shëndetësisë dhe Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave miratojnë programin e monitorimit të mbetjeve spitalore, të detyrueshëm për zbatim nga prodhuesit e këtyre mbetjeve.

11.3 Zotëruesit e mbetjeve spitalore monitorojnë administrimin e mbetjeve me shpenzimet e veta dhe ua dërgojnë këto të dhëna çdo tre muaj Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe inspektorateve respektive në nivel vendor.

KREU VI KONTROLI DHE SANKSIONET

12. Kontrolli

12.1 Ndaj veprimtarisë së zotëruesve të mbetjeve ushtrojnë kontrole Inspektorati i Mjedisit, Inspektorati Sanitar Shtetëror dhe organet e pushtetit vendor.

12.2 Objekt i kontrollit është zbatimi i rregullave dhe kërkesave për:

- a) administrimin e mbetjeve spitalore;
- b) funksionimin e impianteve dhe të instalimeve të përpunimit dhe të asgjësimit të mbetjeve spitalore;
- c) zbatimi i programit të monitorimit sipas pikës 11.2 nga zotëruesit e tyre;
- ç) mbajtjen e regjistrave të veçantë për mbetjet;
- d) plotësimin e kushteve të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë;
- dh) zbatimin e programeve të masave teknike, teknologjike e organizative.

12.3 Kompetencat sipas pikës 12.2, ushtrohen:

- Për shkronjat “a” “c” “ç” “d”, nga Inspektorati Sanitar Shtetëror.
- Për shkronjat “a” “b” “c” “ç” “dh”, nga Inspektorati i Mjedisit;
- Organet e pushtetit vendor.

13. Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kërkesave të kësaj rregulloreje, përbën kundërvajtje administrative, në përputhje me nenin 26 të ligjit nr.7643, datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar”, të ndryshuar dhe nenit 33 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, dhe është objekt i masave administrative mbështetur në nenin 27 të ligjit nr.7643 datë 2.12.1992 “Për Inspektoratin Sanitar”, të ndryshuar dhe nenit 25 të ligjit nr.9537, datë 18.5.2006 “Për administrimin e mbetjeve të rrezikshme”.

14. Zbatimi

Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për ndjekjen dhe zbatimin e kësaj rregulloreje.

Rregullorja nr.6 datë 30.11.2007 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, e miratuar nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, shfuqizohet.

SHTOJCA 1 LLOJET E MBETJEVE SPITALORE TË RREZIKSHME

Kategoria e mbetjeve	Përshkrimi dhe shembuj	Zonat kryesore prodhuese
18 01 01	Instrumente të mprehta (përveç 18 01 03) Instrumente të mprehta të përdorura, si për shembull: age, shiringa, bisturi, brisqe, pajisje të përziera, qelqe të thyera dhe të ndotura, tuba reanimacioni dhe materiale të tjera të ngjashme.	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, salla operacioni, laboratorë dhe qendra kërkimore, banka gjaku, qendra për mbledhjen dhe transfuzionin e gjakut, qendra dialize.
18 01 02	Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (përveç 18 01 03), produktet e gjakut; sende të ndotura me gjak, serume dhe plazmë; kultura dhe grumbullime të agjentëve infektues që krijohen nga laboratorë kërkimorë dhe diagnostikimi dhe materiale të ndotura me agjentë të tillë; mbetje izolimi nga pacientë me koeficient infektimi të lartë; mbetje të mjekimeve dhe të vaksinave; mbetje, shtresa dhe materiale të tjera të infektuara me patogjenë truporë.	Salla operacioni dhe zona kirurgjikale, morgje dhe qendra për realizimin e autopsive, materniteteve dhe klinikave obstetrike.
18 01 08	Mbetjet, grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçantë për të përballuar infeksionet. Mbetje që përmbajnë substanca kimike: Për shembull, kimikate të ngurta, të lëngshme ose në gjendje të gaztë sikurse solventët, reagjentët, dizinfektuesit që kanë skaduar ose që nuk nevojiten më, zhvilluesit e filmave, oksid etileni dhe produkte të tjera kimike që mund të jenë toksikë, gërryes, që digjen lehtësisht, shpërthyes ose kancerogjenë. Ilaçe të skaduara të të gjitha llojeve, sikurse dhe mbetjet e tyre që mund të jenë gjenotoksike, mutogjene, teratogjene ose kancerogjene; sende të ndotura ose që mbajnë produkte farmaceutike (shishe, kuti).	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, salla operacioni, laboratorë dhe qendra kërkimore, banka gjaku, qendra kirurgjikale për mbledhjen dhe transfuzionin e gjakut, qendra dialize, qendra laboratorike dhe kërkimore, qendra shëndetësore, dentistë.
18 01 10	Ilaçe citotoksike dhe citostatike Mbetje amalgame të kujdesit dentar Kontejnerë në presion Cilindra që mbajnë gazra ose aerosole që kur shpohen ose digjen aksidentalisht mund të shpërthejnë. Cilindrat mund të përmbajnë gazra të përdorura për qëllime shëndetësore, dhoma të nxehta ose për përgatitjen e mjekimeve.	Zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, depo farmaceutike dhe kimike, dentistë, laboratorë, zona ku ushtrohet kujdesi shëndetësor, depo farmaceutike dhe kimike, qendra laboratorike dhe kërkimore.

SHTOJCA 2

MODELI NDËRKOMBËTAR I SINJALISTIKËS QË NJOFTON RREZIKUN E MBETJEVE SPITALORE DHE STANDARDI I ETIKETIMIT

SHTOJCA 2.A ETIKETA E KONTEJNITORËVE



Etiketa përfshin shenjën ndërkombëtare dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore, njoftimin e rrezikut mjekësor në shqip dhe në anglisht dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

SHTOJCA 2.B ETIKETA E KOSHAVE

Të gjitha etiketat duhet të prodhohen me materiale që u rezistojnë rrezeve UV, ujit dhe të jenë ngjitëse.

Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e prapme të koshit



Etiketa përfshin shenjën dalluese të rrezikut të mbetjes mjekësore ndërkombëtare, njoftimin e rrezikut të mbetjes mjekësore në shqip dhe anglisht, dhe numrin e parë të klasifikimit ndërkombëtar (6). Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë 14cm x 14cm dhe të ketë formën e një rombi.

Etiketa që duhet të vendoset në pjesën e përparme të koshit

Etiketa dalluese duhet të përcaktojë me germa të mëdha llojin e mbetjes së rrezikshme, përshkrimin shtesë me germa të vogla dhe duhet të mbajë shenjën dalluese të rrezikut. Madhësia minimale e etiketës duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 14cm x 5cm. Etiketa duhet të jetë shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.



Etiketa përshkruese përfshin:

- përshkrimin dhe identifikimin (me germa të bardha në një sfond të zi), “Mbetje spitalore”
N.O.S.

- përcaktimin - “I - infektuese”
- fjalën sinjalizuese “RREZIK”
- njoftimin e rrezikshmërisë “Mund të shkaktojë infeksion”
- Numri i OKB-së “3291”¹
- Klasën e rrezikut “6.2”
- Numrin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve “18.01.03*”
- Numrat EINECS ²
- Shprehja e rrezikut “R21”
- Shprehja e sigurisë “S1/4/24/35/36/37/43; /60
- Deklaratë paralajmëruese
- Identifikimi i furnizuesit
- Personi i kontaktit
- Adresa
- Numri i telefonit dhe celularit
- Madhësia minimale duhet të jetë (gjerësi x lartësi) 21cm x 14cm (A5). Etiketa duhet të jetë shkruar në gjuhën shqipe dhe angleze.

¹ Përfaqëson numra katërshifrorë që identifikojnë mallrat e rrezikshme, substancat dhe artikujt e rrezikshëm etj., që përcaktohen nga Komiteti i Ekspertëve të OKB-së për transportin e mallrave të rrezikshme.

² EINECS kuptohet një numër regjistri i dhënë për çdo substancë kimike të tregtueshme, marrë nga Inventari Europian për Substancat Kimike Ekzistuese.

Mbetjet mjeksore
N.O.S
MEDICAL WASTE
N.O.S

Infektuese
Infectious

Fjala sinjalizuese: **RREZIK**
Signalword: **DANGER**

Shprehja e rrezikshmerise: **mund te shkaktoje infeksion**
Hazard Statement: **may cause infection**

Nr. i UNi / UN - Number: **3291**
Klasa / Class: **6.2**
Katalogu i Mbetjeve:
Waste Catalogue: **18.01.03***

Nr. i EINECSi / EINECS Nr.:

R – Frasa / R - Phrase: **R21**
S – Frasa / S - Phrase: **S1/4/24/35/36/37/43₁/60**

Shprehja parandaluese / Precautionary Statement:

Identiteti i furnizuesit / Supplier Identification:

Personi i Kontaktit / Contact Person:

Adresa / Address:

Numri i Telefonit / Tel Number:

Etiketa e “Destinacionit dhe e Deklarimeve”

Çdo kosh i ambalazhuar, i mbyllur dhe vulosur, duhet të identifikohet me një etiketë që duhet të vendoset në unazën e vulës dhe që tregon:

- Vendndodhjen;
- Gjendjen e ngurtë ose të lëngët;
- Llojin e mbetjes së rrezikshme;
- Datën e grumbullimit;
- Numrin e koshit ose ambalazhimit;
- Sasinë në kg ose litra;
- Nënshkrimin e punonjësit të grumbullimit.

Qendra e Menaxhimit të Mbetjeve të Rrezikshme					
LOKATION.....					
Te ngurta	<input type="checkbox"/>	Te lëngshme	<input type="checkbox"/>	Te ngurta	<input type="checkbox"/>
Bateri	<input type="checkbox"/>	Vaj i përdorur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Bateri Makinash	<input type="checkbox"/>	Acid	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Filter	<input type="checkbox"/>	Alkali	<input type="checkbox"/>		
Pesticide	<input type="checkbox"/>	Pesticide	<input type="checkbox"/>		
Kimikate	<input type="checkbox"/>	Kimikate	<input type="checkbox"/>		
Pleh	<input type="checkbox"/>	Pleh	<input type="checkbox"/>		
				Numri i Kazaneve:	
				Pesha:kg / litra	
Data e grumbullimit:			Kontrollimi i kualitetit:		

SHTOJCA 3
METODA PËR TRAJTIMIN DHE ASGJËSIMIN

1. Incenerim
2. Autoklavim:
 - a) Presion,
 - b) Presion – avull,
 - c) Presion – avull – copëtim.
3. Sterilizim me mikrovalë
4. Sterilizim - UV
5. Trajtim kimik/dizinfektim:
 - a) me shkumës të kloruar;
 - b) me klor aktiv (klor të lirë);
 - c) me peroksid hidrogjeni (H₂O₂);
 - d) me glutininim e proteinave nëpërmjet përdorimit të acideve;
 - e) me ozon (O₃).

SHTOJCA 4
KUSHTET QË DUHET TË RESPEKTOJË TRANSPORTIMI I MBETJEVE SPITALORE
INFEKTUESE

Përveç automjeteve të urgjencës që kthehen nga vende aksidentesh, çdo automjet që transporton mbetje spitalore infektuese duhet të jetë lehtësisht i identifikueshëm gjatë transportimit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore dhe fjalët e përshkruara në shtojcën 2.

Automjetet e përdorura për transportin e mbetjeve spitalore infektuese:

- Duhet të përfshijnë një pjesë ngarkues-transportues, që rri e mbyllur dhe e siguruar përveçse kur ngarkon ose shkarkon mbetje spitalore për të parandaluar hyrjen dhe ekspozimin e paautorizuar ndaj erës dhe reshjeve.

- Duhet të jenë projektuar dhe ndërtuar në mënyre të tillë që të mos lejojë derdhjet;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar pas rrjedhjeve ose derdhjeve aksidentale;
- Duhet të jenë pastruar dhe dizinfektuar para përdorimit për ndonjë qëllim tjetër; dhe
- Nuk duhen përdorur për të transportuar ushqime, produkte ushqimore, kontejnerë ushqimorë ose ndonjë substancë, e cila do të gëlltitet nga njerëzit ose kafshët ose do t'i shtohet ushqimeve të njerëzve ose kafshëve.

Gjatë transportimit të mbetjeve spitalore infektuese, automjetet duhet të mbajnë më vete një kit për ndalimin e derdhjeve dhe për pastrimin e automjetit.

Çdo derdhje prej njëzet (20) ose më shume kilogramësh, duhet të raportohet sa më shpejt që të jetë e mundur te punëdhënësi, Inspektorati Sanitar Shtetëror, Inspektorati Mjedisor, sikurse dhe tek organi kompetent i qeverisjes vendore. Çdo kontakt direkt i mjetit ose pajisjes me mbetjen spitalore duhet të konsiderohet dhe trajtohet si derdhje.

SHTOJCA 5
STANDARDE TEKNIKE PËR INCENERIMIN DHE AUTOKLAVIMIN E MBETJEVE
SPITALORE

Standardet teknike për incenerimin e mbetjeve spitalore përfshijnë standardet e përcaktuara në tabelën 6.1 “Krematori” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.435, datë 12.9.2002 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”.

Ndalohet djegia e mbetjeve të rrezikshme në impiante me fuqi kalorifike më të vogël se 350 kW.

Inceneratorët që përdoren për trajtimin e mbetjeve spitalore, duhet të jenë të pajisur me siguresa ose pajisje të tjera kontrolli, për të ndaluar funksionimin e impiantit djegës nëse nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara në paragrafin e mësipërm 8.10. Në rast se arrihet një temperaturë më e ulët, impianti duhet të jetë i pajisur me djegës ndihmës, të cilët, duke mos llogaritur sasinë e nxehtësisë së mbetjeve, janë në gjendje të mbajnë në mënyrë të pavarur një temperaturë minimale prej 700°C. Përgjegjësi i inceneratorit përgjigjet për:

- Monitorimin dhe regjistrimin e vazhdueshëm të dhomave primare dhe sekondare të djegies;

- Ruajtjen e të dhënave të monitorimeve të kryera për një periudhë shtatëvjeçare.

Të gjitha mbetjet spitalore që mund të digjen, duhet të shndërrohen nga inceneratori në hi që nuk përkon me formën e mbetjeve para djegies. Ky hi që rezulton nga djegia, të paktën një herë çdo tre muaj analizohet duke përdorur përzjerje kampionaturash të rastit për përmbajtjen e karbonit organik total dhe çdo vit analizohet për përmbajtjen e plumbit, merkurit, kaliumit dhe metaleve të rënda. Hiri që rezulton nga djegia nuk duhet të ketë më shumë se 5% karbon (minimalisht 95% djegie).

Mbetja nga djegia ose hiri që përftohet nga procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore është mbetje e ngurtë dhe asgjësohet në përputhje me nenin 21 të ligjit nr.9010, datë 13.2.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”.

Procesi i sterilizimit nëpërmjet autoklavimit duhet të përfshijë në të njëjtin moment procesin e reduktimit volumor dhe të sterilizimit të mbetjeve spitalore. Sterilizimi duhet të bëhet me avull në temperaturën jo më të vogël se 130°C dhe në presionin jo më të vogël se 1.1 bar.

VENDIM
Nr.850, datë 21.10.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSIMIT
VJETOR, INDIVIDUAL, PËR LLOGARITJEN FILLESTARE TË PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 32 e 59 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, sipas viteve, të jenë, si më poshtë vijon:

Për vitin 2009	1.00;
Për vitin 2008	1.04;
Për vitin 2007	1.11;
Për vitin 2006	1.04;
Për vitin 2005	1.02;
Për vitin 2004	1.12;
Për vitin 2003	1.10;
Për vitin 2002	1.09;
Për vitin 2001	1.14;

Për vitin 2000	1.07;
Për vitin 1999	1.09;
Për vitin 1998	1.05;
Për vitin 1997	1.22;
Për vitin 1996	1.09;
Për vitin 1995	1.37;
Për vitin 1994	1.32.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, janë vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga 1.1.2010 dhe përballohen nga buxheti i vitit 2010, miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimi nr.642, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.851, datë 21.10.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E LIBRAZHBIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Librazhdit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Librazhdit.

3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 550 m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të cilëve shpronësohen, është 1 44 650 (njëqind e dyzet e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Librazhdit, planifikuar në buxhetin e saj.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Librazhdit.

8. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Librazhdit, për realizimin e këtij projekti.

9. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 550 m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Librazhdit, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Librazhdit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE

Nr.	Emër, mbiemër	Sip.arë m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Seladin Buzhiqi	550	263	144 650	114/12	1063
	Totali	550		144 650		

VENDIM

Nr.852, datë 21.10.2010

PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES SË FALIMENTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 282/2 të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Organizimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit

1. Agjencia e Mbikëqyrjes së Falimentimit, në vijim Agjencia, është person juridik, publik, në varësi të Ministrit të Drejtësisë.
2. Agjencia drejtohet nga drejtori, i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë.
3. Struktura dhe organika e Agjencisë përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Paga e drejtorit dhe e punonjësve të Agjencisë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat nga tarifat e realizuara nga veprimtaria e saj.
5. Procedura e rekrutimit të nëpunësve të Agjencisë kryhen në përputhje me përcaktimet për këto procedura në legjislacionin e shërbimit civil.
6. Agjencia ushtron veprimtarinë e saj administrative në përputhje me aktet nënligjore, të miratuara nga Ministri i Drejtësisë, në bazë dhe në zbatim të ligjit nr.8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar.

II. Funksionimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit

7. Agjencia është organi kompetent shtetëror për mbikëqyrjen e veprimtarisë së administratorëve të falimentimit dhe për kontrollin e zbatimit të legjislacionit të falimentimit.
8. Drejtori i Agjencisë, përveç kërkesave të tjera në përputhje me dispozitat që rregullojnë emërimin e drejtuesve të institucioneve qendrore, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:
 - a) Të ketë përfunduar program studimi të ciklit të dytë të arsimit të lartë, në degët ekonomi apo drejtësi;
 - b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në profesion;
 - c) Të mos ketë masa disiplinore të largimit nga administrata publike për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore dhe të mos jetë larguar nga shërbimi civil për paaftësi në kryerjen e detyrave;
 - ç) Të ketë titull ose gradë shkencore në administrim biznesi, menaxhim publik apo në të drejtën tregtare.
9. Drejtori i Agjencisë ushtron kompetencat e mëposhtme:
 - a) drejton veprimtarinë e përditshme të Agjencisë;
 - b) përfaqëson Agjencinë në marrëdhëniet me të tretët;
 - c) harton projektbuxhetin vjetor të Agjencisë;

ç) propozon standardet kombëtare për administrimin e masës së falimentimit, si dhe Kodin e Etikës;

d) I propozon për miratim Ministrit të Drejtësisë rregulloren e brendshme organizative të Agjencisë dhe çdo akt tjetër normativ, që i shërben veprimtarisë administrative të kësaj Agjencie;

dh) I raporton çdo vit, ose edhe kur i kërkohet, Ministrit të Drejtësisë për veprimtarinë e Agjencisë;

e) Emëron dhe shkarkon punonjësit e Agjencisë;

ë) Autorizon me shkrim njërin nga punonjësit e Agjencisë për ta zëvendësuar për problemet administrative, në rast të mungesës së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

f) Miraton kërkesat e posaçme të vendeve të punës për rekrutimin e punonjësve të Agjencisë;

g) Lidh kontrata me persona, fizikë e juridikë, vendas e të huaj, në rast se kërkohet ekspertizë e veçantë në ushtrimin e detyrave.

10. Agjencia mban dhe përditëson regjistrin, në formë shkresore dhe elektronike, të administratorëve të certifikuar të falimentimit. Formatit dhe përmbajtja e regjistrit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

11. Agjencia ka të drejtë të mbikëqyrë dhe të kontrollojë periodikisht, në çdo kohë, subjektet e certifikuara prej saj, si dhe të kërkojë e të verifikojë çdo informacion, të cilin e konsideron të nevojshëm për ushtrimin e funksioneve të ngarkuara me ligj. Rregulla më të hollësishme për procedurat e mbikëqyrjes dhe të kontrollit miratohen nga Ministri i Drejtësisë, me propozimin e drejtorit të Agjencisë.

12. Agjencia, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë, organizon dhe zhvillon provimin për administratorët e falimentimit. Rregulla më të hollësishme për procedurat dhe afatet e organizimit të provimit përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2011, për Ministrinë e Drejtësisë.

14. Ngarkohen Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.854, datë 21.10.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “UNAZA FUSHË-ARRËS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik” dhe të nenit 8, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Fushë-Arrës”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, përkatësisht, për sipërfaqen 1531 m², tokë truall, me vlerë 982 902 (nëntëqind e tetëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e dy) lekë, dhe objekte me vlerë 42 200 202 (dyzet e dy milionë e dyqind mijë e dyqind e dy) lekë.

8224

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 655 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, për truall dhe objekte, prej 43 183 104 (dyzet e tre milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e katër) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.11.2010 dhe të përfundojë më 15.2.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë, të rifreskuar, brenda afateve ligjore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, sipas pikave 6 dhe 7 të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pukë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t'i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pukë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat treguese të regjistrimit, si dhe kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Pukë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
 DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA E RIPUNUAR PAS PUBLIKIMIT DHE SHQYRTIMIT TË ANKESAVE TË PRONARËVE, PASURITË E TË CILËVE SHPRONËSOHEN SI REZULTAT
 I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR "UNAZA FUSHË-ARRËZ"

Nr	Emër, atësia, mbiemri	Z.kadastrale	Nr.pasurisë	TRUALL			OBJEKTE		Vlerë që shtohet	Vlera totale lekë	SHËNIME
				Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera në lekë	Lloji i objektit	Vlera në lekë			
1	Fran Ndue Qafa	1656	14	36	642	23112	Bodrum	623382		646494	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
2	Sejdi Mus Sadria	1656	53	48	642	30816	Lokal + Ambiente Sanitare	4900089	5197611	10128516	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
3	Kol Pjetër Kola	1656	6	1002	642	643284	Ambient ndërtimi, përpunim druri	3982489	6768241	11394014	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
4	Zef Lek Ndoci	1656	176	46	642	29532	Pikë karburanti	4492852	561634	5084018	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
5	Zef Lek Ndoci	1656	1161	128	642	82176				82176	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
6	Viktor Ndue Qafa	1656	106	6	642	3852				3852	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
7	Ndrec Ndue Qafa	1656	5	210	642	134820			50076	184896	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
8	Tonin Viktor Qafa	1656	130	55	642	35310	Karburant	5394666		5429976	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
9	Marash Mehil Pepa	1656	1332				Gomisteri	1506408		1506408	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
10	Marjana Mark Bala	1656	14				Bar Bufe	1889646		1889646	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
11	Leonard Nik Leka	1656	1099/1				Kapanon	639941		639941	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
12	Gjovalin Lek Ndoci	1656	84				Karburant	988347	511710	1500057	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
13	Alfred Lek Ndoci	1656	1543				Bar -Bufe	2228712		2228712	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
14	Zef Ndue Qafa	1656	1606				Stallë	1195910		1195910	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
15	Pjeter Preng Bardhoku	1656	90				Gomisteri	678000		678000	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
16	Gjovalin Frrok Prendi	1656					Verandë		590488	590488	Proces regjistrimi,plotësim dokumentacioni
	SHUMA			1531		982902		28520442	13679760	43183104	TOTALI

UDHËZIM
Nr.7, datë 10.11.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.6, DATË 21.10.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10 289, DATË 17.6.2010 “PËR MËNYRËN
E TRAJTIMIT EKONOMIK E FINANCIAR DHE PËR DHËNIE NDIHME TË
MENJËHERSHME FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË
GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, TË
POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT, TË FORCAVE TË
ARMATOSURA, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT DHE TË POLICISË SË
BURGJEVE, QË HUMBIN JETËN NË KRYE APO PËR SHKAK TË DETYRËS””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.6, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, trajtimi me strehim i familjeve të punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin nr.6257, datë 2.9.2008 të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe të Ministrit të Financave “Për përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”, të ndryshuar, duke përfutur subvencionim të plotë të interesit të kredisë (kredi me interes 0%) sipas pikave 7 e vijuese të udhëzimit.

Lista e miratuar nga Ministria e Brendshme i përcillet Entit Kombëtar të Banesave, i cili e trajton me përparësi duke e dërguar në bankën e përzgjedhur nga Ministria e Financave për zbatimin e programit të subvencionit për familjet, që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti. Lista e miratuar nga Ministria e Brendshme duhet të shoqërohet me:

- Certifikatë të gjendjes familjare aktuale.

- Vërtetim negativ nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e vendit ku banojnë, që, në emër të kryefamiljarit dhe të anëtarëve të tjerë të familjes, nuk figuron pronë e regjistruar apo në proces regjistrimi.”.

2. Pika 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij udhëzimi.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.22, datë 29.7.2010

**PËR EMËRIMET E PERSONELIT MËSIMOR DHE DREJTUES NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1999 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin e arsimit parauniversitar”, të ndryshuar, të vendimit nr.66, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore”,

UDHËZOJ:

1. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore (DAR/ZA) të rretheve të përgjigjen për gjendjen e personelit mësimor. Ato përcaktojnë vendet e lira në organikë, nevojat sipas profileve dhe nevojave për zëvendësimet në të gjitha nivelet e mësuesve pa arsim përkatës.

2. Për arsimin parashkollor dhe për ciklin fillor (klasat 1-5), mësuesit definitivë duhet të kenë diplomë të shkollës së lartë me specialitetin në mësuesi.

3. Mësuesit që kanë mbaruar shkollën e mesme pedagogjike ose një shkollë tjetër të profilizuar në mësuesi, siç janë shkollat e mesme: të muzikës, artistike, të gjuhëve të huaja ose të edukimit fizik, me kusht që të kenë fituar të tria shkallët e kualifikimit, të konsiderohen mësues me arsim përkatës.

4. Në arsimin parashkollor dhe në ciklin fillor, DAR/ZA-të (punëdhënësi), për nevoja objektive të veçanta, që lidhen me veçori dhe specifika të secilit rreth, mund të punësojnë me kontratë pune me afat njëvjeçar, mësues që kanë mbaruar shkollën e mesme pedagogjike ose një shkollë tjetër të mesme të propozuar në mësuesi, pavarësisht se nuk përmbushin kriterin e fitimit të shkallëve të kualifikimit. Për arsimin parashkollor dhe për ciklin fillor, të konsiderohen pa arsim përkatës edhe punonjësit që ndjekin studimet e larta në mësuesi, me korrespondencë, me kohë të pjesshme ose që nuk kanë diplomë të shkollës së mesme pedagogjike. Në asnjë rast, ata nuk duhet të punësohen me emërim definitiv.

5. Për arsimin e mesëm të ulët (klasat 6-9), mësuesit definitivë duhet të kenë diplomë universitare 3-vjeçare, të lëshuar nga ish-institutet e larta pedagogjike, diplomë 4-vjeçare në mësuesi ose Master të Nivelit të Parë (MNP) për arsimin e mesëm të ulët.

6. Në klasat e arsimit të mesëm të përgjithshëm, pranë shkollave të mesme të bashkuara dhe në gjimnaze, mësuesi duhet të ketë përfunduar studimet universitare me kohë të plotë, që kanë zgjatur 4 ose 5 vite, ose Master të Nivelit të Parë (MNP) për arsimin e mesëm të lartë. Për lëndët teknologji, ekonomi dhe teknologji informacioni dhe komunikimi, mësuesi të ketë një diplomë universitare që është fituar në përfundim të 4 viteve studimi ose një diplomë Master të Nivelit të Parë (MNP) në fushën e arsimit përkatës. Kjo kategori mësuesish vitin e parë të punës në arsim të punësohet me kontratë individuale me afat njëvjeçar.

7. Mësuesit që kanë kryer studimet e larta në mësuesi dhe kanë fituar tri shkallë kualifikimi dhe nuk japin mësim në profilin përkatës, por në profile të përafërta me to, të konsiderohen mësues me arsim përkatës vetëm në arsimin bazë.

8. Në shkollat e mesme profesionale të zhvillojnë mësim teorik vetëm mësuesit që kanë diplomë universitare të specialitetit përkatës të nivelit 4-vjeçar, diplomë e nivelit të parë dhe Master të Nivelit të Parë (3+1) ose diplomë e nivelit të parë dhe diplomë e nivelit të dytë (2+3). Instruktorët mund të jenë dhe me arsim të mesëm profesional.

9. Në rast nevoje, në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të punësohen edhe mësues me arsim të lartë që nuk e kanë të përcaktuar në diplomë nivelin e mësimdhënies.

10. Në raste të veçanta, për nevojat të zhvillimit normal të procesit mësimor, DAR/ZA-të mund të angazhojnë edhe mësues në pritshmëri, që plotësojnë kriteret e caktuara për nivelin përkatës ku japin mësim. Pagesa në këto raste bëhet me orë mësimore, të cilat vlerësohen në bazë të tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

11. Mësuesit, të cilët nuk plotësojnë kriteret e mësipërme të punësimit për të gjitha ciklet e sistemit të arsimit parauniversitar, të konsiderohen pa arsim përkatës.

12. Për vendet e lira, kur paraqiten dy a më shumë kandidatura, të aplikohet konkursi, sipas modaliteteve të parashikuara në pikën 4.3 të nenit 4 të kontratës kolektive të punës 2010-2014, të nënshkruara ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë dhe Federatës së Sindikatave të Arsimit të Shqipërisë, datë 25.5.2010. Në të njëjtën mënyrë të veprohet për emërimin e personelit drejtues të shkollave.

13. Për personelin mësimor dhe drejtues të shkollave me status “Shkolla të nivelit kombëtar” të zbatohen procedurat e përcaktuara në urdhrin nr.490, datë 27.12.2005 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, si dhe në rregulloren për shkollat që fitojnë statutin “Shkolla të nivelit kombëtar” nr.8937, datë 22.12.2005.

14. Për rekrutimin e mësuesve në shkollat e veçanta (speciale) të zbatohen kriteret që jepen në dispozitat normative (për arsimin parauniversitar). Në këto institucione t’i jepet përparësi punësimit të specialistëve të fushës përkatëse.

15. Shërbimi psikologjik në institucionet arsimore publike të mbulohet nga specialistë me arsim të lartë në psikologji.

16. Në çdo rast, zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëmarrësi të bëhet, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, duke ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara në Kodin e Punës.

17. Ndryshimi i vendit të punës gjatë vitit shkollor të bëhet vetëm në rastet kur ekzistojnë shkaqe objektive, veçanërisht për nevoja madhore në arsim.

18. Për të gjitha emërimet e reja t’u jepet përparësi mësuesve me arsim përkatës, sipas pikave të mësipërme.

19. Udhëzimi nr.29, datë 18.9.2006 “Për emërimet dhe lëvizjet e personelit mësimor dhe drejtues në arsimin parauniversitar”, revokohet.

20. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Koordinimit Rajonal dhe Decentralizimit, Drejtoria e Programeve të Zhvillimit në MASH, si dhe drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat e arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Myqerem Tafaj

UDHËZIM

Nr.28, datë 10.9.2010

PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, pika 5, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”; të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar; të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”,

UDHËZOJ:

1. Pranimi i kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë (IAL), në vitin akademik 2010-2011, të bëhet sipas listave emërore të renditura nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH).

2. Kandidatët fitues të përcaktohen nga APRIAL në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme, të provimeve të “Maturës Shtetërore”, të detyruara dhe me zgjedhje, dhe për disa programe studimi, edhe të rezultateve të konkursit të zhvilluar në bazë të udhëzimit nr.19, datë 15.7.2010 të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës “Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurrim, në disa programe studimi në ciklin e parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë, për vitin akademik 2010-2011”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë për programin e studimit të përzgjedhur nga ata vetë në formularin A2.

3. Pas përfundimit të konkurseve në të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, rezultatet e tyre në format elektronik dhe *hard copy* të dorëzohen nga këto të fundit në APRIAL brenda orës 14.00 të datës 10.9.2010. APRIAL-i, brenda datës 13.9.2010, të dërgojë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat paraprake të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve të studimit përkatës, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe të preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A2, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit, për vitin akademik 2010-2011”.

4. Lista paraprake të kandidatëve fitues shpallen në *website* në APRIAL-it dhe MASH-it dhe u dërgohen, në formën e shkruar dhe elektronike, institucioneve publike të arsimit të lartë nëpërmjet Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH, në datën 13.9.2010. Këto institucione, duke filluar nga data 13.9.2010, t'i afishojnë listat në vende të dukshme në mjediset e fakulteteve përkatëse.

5. Për organizimin dhe realizimin e procesit të pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë të ngarkohen fakultetet e institucioneve publike të arsimit të lartë. Ky proces do të jetë nën monitorimin e rektorateve dhe të Ministrisë së Arsimit e të Shkencës.

6. Regjistrimi i kandidatëve për të fituar statusin e studentit të pranuar në institucionet publike të arsimit të lartë të zhvillohet në tri faza:

6.1 regjistrimi paraprak,

6.2 regjistrimi i ndërmjetëm,

6.3 regjistrimi përfundimtar.

7. Regjistrimi paraprak

7.1 Kandidatët fitues bëjnë regjistrimin paraprak të tyre në programin e studimit ku janë shpallur paraprakisht fitues pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në datat: 14, 15, 16, 17, 18, 19 shtator 2010, nga ora 08:00 deri në orën 18:00.

7.2 Për regjistrimin paraprak, kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie (në mungesë të origjinalit, vërtetën me listë notash me fotografi, ose dokument me fotografi i lëshuar nga Arkivi i Shtetit me notat përkatëse të nënshkruara nga drejtori dhe nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/zyrës arsimore);

b) Dokument identifikimi (letërnjoftim ID, pasaportë) dhe fotokopje të tij. Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 1550 lekë, paguar në një nga bankat e nivelit të dytë.

7.3 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit paraprak, sekretaritetë mësimore të fakulteteve mbajnë regjistër të veçantë, në të cilin kandidatët fitues nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve, duke shënuar datën dhe orën e regjistrimit.

7.4 Sekretaria mësimore pajis kandidatin që bën regjistrimin paraprak me një fletë-regjistrimi paraprak, ku shtohen numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi paraprak duhet të jetë i nënshkruar nga dekani dhe kryesekretarja mësimore e fakultetit dhe i vulosur.

8. Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në orën 14:00 të datës 21.9.2010, të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL, listën origjinale të përgatitur nga APRIAL-i me regjistrimet paraprake të kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas udhëzimit të përgatitur nga APRIAL-i.

9. Kandidatët, të cilët nuk kryejnë regjistrimin paraprak brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdolloj arsye, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe të vazhdimit të procesit. Këta kandidatë nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

10. Në bazë të regjistrimeve paraprake të kryera dhe të vendeve të paplotësuara, APRIAL-i, në datën 25 shtator 2010, të shpallë listën e ndërmjetme të kandidatëve fitues, duke ruajtur parimet e shprehura në pikën 2 të këtij udhëzimi. Lista shpallet edhe në *website* të APRIAL-it dhe MASH-it.

11. Listat e ndërmjetme të kandidatëve fitues, në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit, në datën 26 shtator 2010 nga APRIAL-i, nëpërmjet Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH. Këto institucione t'i afishojnë listat brenda datës 25 shtator 2010.

12. Regjistrimi i ndërmjetëm

12.1 Kandidatët, të cilët në listat e ndërmjetme janë shpallur fitues në një program studimi të një preference të tyre më të lartë se ai i regjistrimit paraprak, do të çregjistrohen nga vetë sekretaritetë mësimore nga programi i studimit ku ishin regjistruar më parë. Këta kandidatë tërheqin dosjen individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 7.2 të këtij udhëzimi nga sekretaritetë mësimore ku janë çregjistruar dhe regjistrohen në programin e studimit, në të cilin janë shpallur fitues me listat e ndërmjetme.

12.2 Sekretaritetë mësimore të fakulteteve, në datat: 27, 28, 29, 30 shtator dhe 1 tetor 2010, nga ora 08:00 deri në orën 18:00, të kryejnë çregjistrimet e kandidatëve të përcaktuar në pikën 12.1 dhe të regjistrojnë kandidatët e rinj fitues sipas listave të ndërmjetme të fituesve të shpallur nga APRIAL-i dhe të dërguara nëpërmjet MASH-it.

12.3 Veprimet e çregjistrimit paraprak dhe ato të regjistrimit të ndërmjetëm të kandidatëve të rinj të dokumentohen në regjistër të veçantë.

12.4 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të ndërmjetëm në sekretaritetë mësimore të fakulteteve, kandidatët fitues që janë ngjitur në preferencë më të lartë kundrejt regjistrimit paraprak, nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve në regjistrin e veçantë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 3.7 të këtij udhëzimi.

12.5 Sekretaria mësimore duhet ta pajisë kandidatin që bën regjistrimin, sipas nenit 12.4, me fletë-regjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data e ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekanin dhe nga kryesekretarja mësimore e fakultetit, dhe të jetë i vulosur.

12.6 Kandidatët, të cilët edhe në listat e ndërmjetme rezultojnë fitues në të njëjtin program studimi, nuk është e nevojshme të regjistrohen.

12.7 Tarifa e regjistrimit prej 1550 lekësh, e arkëtuar për regjistrimin paraprak në universitetin X, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit ku universiteti X ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të universitetit Y, në të cilin është realizuar regjistrimi i ndërmjetëm i studentit dhe i shoqëruar me listën e studentëve.

13. Institucionet publike të arsimit të lartë, deri në orën 14:00 të datës 3.10.2010, të dorëzojnë në MASH dhe në APRIAL, listën origjinale të përgatitur nga APRIAL-i, me regjistrimet e ndërmjetme të kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, në dy kopje, sipas udhëzimit të përgatitur nga APRIAL-i.

14. Kandidatët, të cilët nuk kryejnë regjistrimin e ndërmjetëm brenda datave të përcaktuara në këtë udhëzim, për çfarëdo lloj arsyeje, humbasin të drejtën e regjistrimit dhe nuk do të përfshihen në listën përfundimtare të fituesve.

15. Në bazë të regjistrimeve të ndërmjetme të kryera dhe të vendeve të paplotësuara, APRIAL-i në datën 6 tetor 2010, të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues duke ruajtur parimet e shprehura në pikën 2 të këtij udhëzimi. Lista shpallet edhe në *website* të APRIAL-it dhe MASH-it.

16. Listat përfundimtare të kandidatëve fitues, në formë të shkruar dhe elektronike, t'u dorëzohen institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas programeve përkatëse të studimit, në datën 6 tetor 2010 nga APRIAL-i, nëpërmjet Drejtorisë së Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH. Këto institucione t'i afishojnë listat, brenda datës 6 tetor 2010.

17. Regjistrimi përfundimtar

17.1 Kandidatët, të cilët në listat përfundimtare janë shpallur fitues në një program studimi të një preference të tyre më të lartë se ai i regjistrimit të ndërmjetëm, do të çregjistrohen automatikisht nga sekretaritetë mësimore nga programi i studimit ku ishin regjistruar më parë. Këta kandidatë tërheqin dosjen individuale me dokumentet e cilësuar në pikën 7.2 të këtij udhëzimi, nga sekretaritetë mësimore ku janë çregjistruar dhe regjistrohen në programin e studimit, në të cilin janë shpallur fitues me listat përfundimtare.

17.2 Sekretaritetë mësimore të fakulteteve, në datat 7,8,9, tetor 2010, prej orës 08:00 deri në orën 18:00, të kryejnë çregjistrimet e kandidatëve të përcaktuar në pikën 17.1 dhe të regjistrojnë kandidatët e rinj fitues, sipas listave përfundimtare të fituesve, të shpallura nga APRIAL-i dhe të dërguara nëpërmjet MASH-it.

17.3 Veprimet e çregjistrimit të ndërmjetëm dhe ato të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve të rinj, të dokumentohen në regjistër të veçantë.

17.4 Në kryerjen e procedurës së regjistrimit përfundimtar në sekretaritetë mësimore të fakulteteve, kandidatët fitues që janë ngjitur në preferencë më të lartë kundrejt regjistrimit të ndërmjetëm, nënshkruajnë në momentin e regjistrimit për dorëzimin e dokumenteve, në regjistrin e veçantë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në pikën 7.3 të këtij udhëzimi.

17.5 Sekretaria mësimore duhet ta pajisë kandidatin që bën regjistrimin, sipas nenit 7.4, me fletë-regjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, si edhe data e ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi duhet të jetë i nënshkruar nga dekanin dhe nga kryesekretarja mësimore e fakultetit, dhe të jetë i vulosur.

17.6 Kandidatët, të cilët edhe në listat përfundimtare rezultojnë fitues në të njëjtin program studimi, nuk është e nevojshme të regjistrohen.

17.7 Tarifa e regjistrimit prej 1550 lekësh, e arkëtuar për regjistrimin e ndërmjetëm në universitetin X, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës thesarit ku universiteti Y ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të universitetit Y, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i studentit dhe i shoqëruar me listën e studentëve.

18. Në përfundim të procesit të regjistrimit, studentët e regjistruar në regjistrin e veçantë të regjistrohen në regjistrin bazë të studentëve në vijim të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit" dhe të urdhrin nr.150, datë 7.4.2008 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "Për përcaktimin e kodit të regjistrave të studentëve në IAL".

19. Listat e kandidatëve fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, për shqiptarët nga trojet jashtë vendit, përjashtuar kandidatët nga Republika e Kosovës, të përcaktuar nga institucionet përgjegjëse të vendeve përkatëse, në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara vendimin nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave "Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit, për vitin akademik 2010-2011", dërgohen nga Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH, në institucionet publike të arsimit të lartë, deri më 30 shtator 2010.

19.1 Listat e kandidatëve fitues, sipas programeve të ndryshme të studimit, për shqiptarët nga Republika e Kosovës, të përcaktuara nga institucionet e arsimit të lartë pritëse në përputhje me kuotat e pranimeve të miratuara me vendimin nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, dërgohen në formë të shkruar dhe elektronike në dy kopje, nga IAL-të në Drejtorinë e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në MASH, deri më 30 shtator 2010.

19.2 Administrimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e kandidatëve nga Republika e Kosovës bëhet nga IAL-të pritëse mbështetur në notën mesatare të shkollës së mesme edhe notat e lëndëve për të cilat IAL-të kanë vendosur koeficientët më të lartë për pranimet në këtë vit akademik.

20. Kandidatët shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja të regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve në datat 4, 5 dhe 6 tetor 2010, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 7.2. Dokumentet e parashtruara në pikat 7.2.a dhe 7.2.b të jenë në gjuhën shqipe e të noterizuara në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të regjistrimeve të këtyre kandidatëve të njoftohet MASH-i.

21. Me mbylljen e procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në APRIAL dhe në MASH listat përfundimtare origjinale të përgatitura nga APRIAL-i, me regjistrimet e kryera për çdo program studimi të ciklit të parë me kohë të plotë, të plotësuar, sipas udhëzimit të APRIAL-it për regjistrimin përfundimtar, në formë të shkruar dhe elektronike dhe dy kopje, deri në datën 13 tetor 2010.

22. Rektoratet dhe dekanatet në datën 13.9.2010, të shpallin në mënyrë të qartë dhe në vende të dukshme, në mjediset fakulteteve përkatëse: data dhe oraret e veprimeve të regjistrimit dhe të çregjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si dhe njoftime që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e një ecurie normale të procesit të pranimeve të ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

23. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

24. Ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe Institucionet Publike të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.29, datë 5.10.2010

**PËR STRUKTURËN E VITIT AKADEMIK 2010-2011 NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË
ARSIMIT TË LARTË DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR ZBATIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 32 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë me kohë të plotë, të fillojë më 11 tetor 2010 dhe të përfundojë më 30 shtator 2011.

2. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, të fillojë në datën 25 tetor 2010 dhe të përfundojë më datën 30 shtator 2011.

3. Viti akademik 2010-2011 në institucionet publike të arsimit të lartë, në programet e studimit me kohë të pjesshme dhe edukim në distancë, të fillojë në datën 1 nëntor 2010 dhe të përfundojë në 30 shtator 2011.

4. Periudha 24 dhjetor 2010 deri më 3 janar 2011 të jetë periudhë pushimesh për studentët.

5. Nga institucionet publike të arsimit të lartë të merren masat për zbatimin e udhëzimit të Ministrisë nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit” për të pajisur me numrat e matrikullimit të gjithë studentët e vitit të parë deri më 26 nëntor 2010.

6. Të dhënat e regjistrave të njëjësive kryesore të dërgohen në MASH në formë elektronike në programin Excel brenda datës 17 dhjetor 2010.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë, në përfundim të regjistrimit përfundimtar të kandidatëve fitues, të dërgojnë në drejtorinë e konvikteve listën e studentëve të regjistruar, sipas programeve të studimit dhe fakulteteve përkatëse.

8. Ngarkohen Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe e Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi për vitin akademik 2010-2011.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.30, datë 6.10.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.28, DATË 10.9.2010 “PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës pika 5, të nenit 33 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”,

UDHËZOJ:

I. Pikat 20 dhe 21 të udhëzimit nr.28, datë 10.9.2010 “Për procedurat e pranimit dhe të regjistrimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2010-2011”, ndryshohen si më poshtë:

“20. Kandidatët shqiptarë nga Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja të regjistrohen pranë sekretarive mësimore të fakulteteve deri më datë 22 tetor 2010, duke paraqitur dokumentet përkatëse, sipas pikës 7.2. Dokumentet e parashtruara në pikat 7.2a dhe 7.2b të jenë në gjuhën shqipe dhe të noterizuara në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim të regjistrimeve të këtyre kandidatëve të njoftohet MASH-i.

21. Në përfundim të procesit të regjistrimeve, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në APRIAL dhe në MASH listat përfundimtare origjinale me regjistrimet sipas programeve të studimit për ciklin e parë me kohë të plotë, në formë të shkruar dhe elektronike në dy kopje, deri në datën 25 tetor 2010.”.

II. Ngarkohen zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë (APRIAL), Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.31, datë 11.10.2010

**PËR PROCEDURAT E PRANIMIT DHE TË REGJISTRIMIT NË PROGRAMET E
STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË ME KOHË TË PLOTË, NË INSTITUCIONET PUBLIKE
TË ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 34 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve, “Master i Shkencave”, për vitin akademik 2010-2011”, të vendimit nr.795, datë 6.10.2010 “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, për vitin akademik 2010-2011”,

UDHËZOJ:

1. Pranimin e aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2010-2011, në bazë të përzgjedhjes së bërë nga institucionet publike të arsimit të lartë.

2. Aplikantët fitues përzgjidhen nga institucionet publike të arsimit të lartë në bazë të kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucionet publike të arsimit të lartë dhe të publikuara më parë.

3. Njësitë kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë organizojnë procesin e pranimit dhe të regjistrimit të aplikantëve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë. Procesi të monitorohet nga rektorati dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

4. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin menjëherë hapjen e procedurës së pranimit të kërkesave për aplikantët që dëshirojnë të vazhdojnë programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë.

5. Aplikimet në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë të kryhen nga data 13.10.2010 deri në datën 21.10.2010, prej orës 8.00 deri në orën 18.00 pranë sekretarive mësimore të njësive kryesore. Për aplikim, kandidati të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet e mëposhtme:

a) Kopje të noterizuar të diplomës së ciklit të parë të studimeve të shoqëruara me listën origjinale të notave;

b) Dokument identifikimi (letërnjoftim ID, pasaportë) dhe fotokopje të noterizuar të tij. Në dosje mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit;

c) 2 fotografi;

d) Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit prej 2500 lekësh.

6. Pranë njësive kryesore përgjegjëse të institucioneve publike të arsimit të lartë për çdo program studimi të ciklit të dytë me kohë të plotë të ngrihen komisione *ad-hoc* sipas fushave përkatëse, për përzgjedhjen e aplikantëve fitues në përputhje me kriteret e pranimit të vendosura dhe të shpallura publikisht nga këto institucione.

7. Institucionet publike të arsimit të lartë të shpallin dhe të afishojnë listat e aplikantëve fitues në vende të dukshme, në mjediset e njësive kryesore përkatëse, brenda orës 16:00 të datës 26.10.2010, të ndarë sipas programeve të studimit përkatëse, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve të grumbulluara nga aplikantët, në përputhje me kuotat e pranimeve, të miratuara me vendimin nr.786, datë 29.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave”, me kohë të plotë, si dhe tarifat e shkollimit për programet e studimit të miratuara për vitin akademik 2010-2011” dhe vendimin nr.795, datë 6.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master Profesional”, për vitin akademik 2010-2011”.

8. Regjistrimi i aplikantëve në programet e studimit ku janë shpallur fitues të zhvillohet nga data 27.10.2010 deri në datën 30.10.2010 prej orës 8:00 deri në orën 18:00 pranë sekretarive mësimore të njëjve kryesore të institucioneve publike të arsimit të lartë. Dokumentet e aplikantëve jofitues t'u kthehen personave kundrejt kërkesës. Për regjistrimin kandidati duhet të paraqitet personalisht pranë sekretarive mësimore dhe të dorëzojë dokument origjinal: dëftesën e pjekurisë (në mungesë, lista e notave me fotografi, e nënshkruar nga drejtori i shkollës e nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/zyrës arsimore, ose dokument i lëshuar nga Arkivi i Shtetit me notat përkatëse).

9. Pas mbylljes së procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listat përfundimtare origjinale me regjistrimet e kryera brenda datës 10.11.2010, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

10. Institucionet publike të arsimit të lartë, duke filluar nga data 12.10.2009, të shpallin në vende të dukshme datat dhe oraret e veprimeve të konkurrimit dhe të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të nevojshme për regjistrim, si edhe njoftime të tjera që i gjykojnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë.

11. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar e elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

12. Ngarkohen sekretari i përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, si edhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

UDHËZIM
Nr.32, datë 21.10.2010

**PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE FITUES NË CIKLIN E PARË TË STUDIMEVE
ME KOHE TË PLOTË NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË PËR
PLOTËSIMIN E KUOTAVE TË PAREALIZUARA, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 33 të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar, të vendimit nr.503, datë 16.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe të vendimit nr.78, datë 8.2.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta publike”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Të regjistrohen në institucionet publike të arsimit të lartë, në ciklin e parë të studimeve, sipas programeve përkatëse të studimit, kandidatët që shpallen fitues nga kuotat e parealizuara, pas përfundimit të regjistrimeve në programet e studimit të ciklit të parë me kohë të plotë.

2. Kandidatët që aplikojnë vetëm për vendet e shpallura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në tabelën bashkëngjitur vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar.

3. Kandidatët fitues përcaktohen nga Agjencia Kombëtare e Pranimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë (APRIAL), në bazë të dy parimeve:

a) Parimi i meritës: sipas pikëve të grumbulluara në bazë të rezultateve të shkollës së mesme dhe provimeve të “Maturës Shtetërore”.

b) Parimi i vullnetit të kandidatëve, i shprehur nëpërmjet preferencës më të lartë të zgjedhur prej tyre në formularin A3.

4. Kanë të drejtë të plotësojnë formularin A3 të gjithë kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A2 dhe:

a) nuk kanë mundur të përfshihen në listat e fituesve për t’u regjistruar në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011;

b) janë përfshirë në listat e fituesve dhe nuk janë regjistruar në institucionet publike të arsimit të lartë në vitin akademik 2010-2011.

5. Formulari A3 përmban të gjitha kuotat për secilin program studimi, të përcaktuara në tabelën bashkëngjitur vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar dhe mundëson orientimin për aplikim në programet e studimit, të preferuara nga kandidati, në bazë të pikëve të fituara dhe të pikëve të fituesit të fundit.

6. APRIAL-i të shpërndajë formularin A3 në DAR/ZA-të më 21.10.2010.

7. DAR/ZA-të ta shpërndajnë formularin A3 në shkolla në datën 22.10.2010 deri në datën 23.10.2010.

8. Kandidatët/maturantët e përcaktuar në pikën 4 ta tërheqin formularin A3 në shkollat respektive ku kanë tërhequr formularin A2 dhe ta kthejnë atë të plotësuar me preferencat e tyre brenda datës 27.10.2010.

9. Drejtoritë e shkollave t’i dorëzojnë formularët A3, të plotësuar dhe të paplotësuar me procesverbal pranë DAR/ZA-ve përgjegjëse, brenda datës 27.10.2010.

10. DAR/ZA-të t’i dërgojnë në APRIAL formularët A3 në datën 28.10.2010.

11. APRIAL-i të përpunojë të dhënat e marra nga formularët A3 dhe në datën 4.11.2010 të shpallë listën përfundimtare të kandidatëve fitues, të ndarë sipas programeve përkatëse të studimit, të renditur sipas rendit zbritës të pikëve dhe sipas preferencës më të lartë të kërkuar prej tyre në formularin A3, në përputhje me kuotat e rishpërndara dhe njëkohësisht ta dorëzojë këtë listë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

12. APRIAL-i të dorëzojë, në datën 4.11.2010, në formë të shkruar dhe elektronike, listat përfundimtare të kandidatëve fitues, sipas programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të. Këto institucione të afishojnë menjëherë listat në vende të dukshme në mjediset e tyre.

13. Regjistrimi i kandidatëve fitues të bëhet pranë sekretarive mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë në datat 5, 6, 7, 8 nëntor, nga ora 8.00 deri në orën 18.00. Për regjistrim, kandidati duhet të dorëzojë dosjen individuale, me dokumentet origjinale të mëposhtme:

a) Dëftesë pjekurie (në mungesë, listë notash me fotografi, të nënshkruar nga drejtori i shkollës dhe nga drejtori i drejtorisë arsimore rajonale/drejtori i zyrës arsimore, ose listë notash të lëshuar nga Arkivi i Shtetit);

b) Dokument identifikimi (kartë identiteti, pasaportë) origjinalin dhe fotokopjen e tij. Në dosje të mbahet vetëm fotokopja e dokumentit të identifikimit, në mungesë të tyre, kandidati dorëzon certifikatën personale me fotografi;

c) 2 fotografi;

ç) Mandat-arkëtimi të tarifës së regjistrimit prej 1550 lekësh të lëshuar nga bankat e nivelit të dytë, në Shqipëri.

14. Në kryerjen e procedurës së regjistrimit të kandidatëve fitues, sekretaritë mësimore të institucioneve publike të arsimit të lartë të regjistrojnë studentët në regjistrin bazë të studentëve, në bazë të udhëzimit nr.19, datë 18.7.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matricullimit”.

15. Sekretaria mësimore të pajisë kandidatin me fletë-regjistrimi, ku të shënohet numri i regjistrimit, emri i kandidatit, data dhe ora e regjistrimit. Fletë-regjistrimi duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga titullari i institucionit publik të arsimit të lartë/i njësisë kryesore që kryen regjistrimin dhe nga kryesekretari mësimor.

16. Për kandidatët/maturantët që e kanë likuiduar tarifën e regjistrimit në një nga fazat e regjistrimit me formularin A2, nuk është e nevojshme të bëjnë pagesë të re. Tarifa e regjistrimit prej 1550 lekësh, e arkëtuar nga kandidati/maturanti në fazat e mëparshme, të kalojë me xhirim nga llogaria e degës së thesarit, ku institucioni publik i arsimit të lartë ka llogarinë buxhetore, në llogarinë e thesarit të institucionit tjetër publik të arsimit të lartë, në të cilin është realizuar regjistrimi përfundimtar i kandidatit/maturantit me formularin A3.

17. Pas përfundimit të procesit të regjistrimit, institucionet publike të arsimit të lartë të dorëzojnë në APRIAL listat përfundimtare origjinale, të përgatitura nga APRIAL-i, me regjistrimet e kryera, në formë të shkruar dhe elektronike, brenda datës 10.11.2010.

18. Institucionet publike të arsimit të lartë, nga data 4.11.2010, të shpallin në vende të dukshme, në mjediset e tyre, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumenteve të domosdoshme për regjistrim, si edhe të dhëna të tjera që i gjejnë të nevojshme për sigurimin e ecurisë normale të procesit të pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, në institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Këto njoftime të bëhen publike edhe në median e shkruar dhe elektronike nga institucionet publike të arsimit të lartë.

20. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi zëvendësministri i Arsimit dhe Shkencës, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, APRIAL-i, institucionet publike të arsimit të lartë dhe DAR/ZA-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

URDHËR
Nr.460, datë 11.10.2010

**PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR NJË PROGRAM TË DYTË
STUDIMI DHE TË KUOTAVE PËR TRANSFERIM STUDIMESH, NË CIKLIN E PARË TË
STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të neneve 33, 35 dhe 36 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në shkronjat “b”, “c”, të pikës 1, pikave 12, 13,14, 15, 16, 17 të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”,

URDHËROJ:

1. Shpërndarjen e kuotave të pranimit për një program të dytë studimi, si dhe të kuotave për transferim studimesh në institucionet publike të arsimit të lartë për vitin akademik 2010-2011, sipas shkronjave “b”, “c”, të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.586, datë 7.7.2010 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, mbështetur në kërkesën e institucioneve publike të arsimit të lartë.

2. Kuotat e pranimit për një program të dytë studimi, dhënë institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas shkronjës “b” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.586, datë 7.7.2010 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të

plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, të shpërndahen, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë të tabelës nr.2, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Kuotat e transferimeve të studimeve dhënë institucioneve publike të arsimit të lartë, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.586, datë 7.7.2010 “Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, të shpërndahen sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij urdhri.

4. Kuotat e transferimit të studimit, të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.586, datë 7.7.2010 “Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i lartë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, të shfrytëzohen edhe për transferime nga institucionet private të arsimit të lartë, drejt institucioneve publike të arsimit të lartë, deri në masën 30% të kuotës për transferim të përcaktuar për çdo program studimi.

5. Kuotat e dhëna institucioneve publike të arsimit të lartë për një program të dytë studimi dhe kuotat e dhëna për transferime, sipas shkronjave “b” dhe “c” të pikës 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.586, datë 7.7.2010 “Për kuotat e pranimin në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2010-2011”, të shpërndahen, duke respektuar nga këta të fundit kriteret e vendosura në përputhje me aktet nënligjore dhe të publikuara më parë në vende të dukshme prej tyre.

6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, si dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS
Myqerem Tafaj

Tabela nr.1

KUOTAT PËR TRANSFERIM STUDIMESH PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	AA	UST	UD	TOTALI
1	Histori	4						1				5
2	Gjeografi	4						1				5
3	Histori-gjeografi				1							1
4	Gjuhë-letërsi	4				1		1				6
5	Gazetari	4						1				5
6	Gjuhë angleze	12			1			1				14
7	Gjuhë frënge	1			1			1				3
8	Gjuhë italiane	1						1				2
9	Gjuhë gjermane	1						1				2
10	Gjuhë turke	6										6
11	Cikli i ulët				1	1						2
12	Cikli i ulët parashkollor											0
13	Fushat e veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacion									1		1
14	Edukim fizik dhe sporte				1			1				2
15	Matematikë	2						1				3
16	Fizikë	2						1				3
17	Biologji-kimi	2			1			1				4
18	Matematikë-informatikë					2						2
19	Informatikë	2						1				3
20	Punë sociale	1						1				2
21	Filozofi	2										2
22	Sociologji	2										2
23	Psikologji	2						1				3
24	Shkenca politike	2										2
25	Drejtësi	44						2				46
26	Regji filmi dhe TV								2			2
27	Aktrim								1			1
28	Skulpturë								1			1
29	Oboe								1			1

30	Pedagogji muzikore											0
31	Mjekësi e përgjithshme	8										8
32	Stomatologji	6										6
33	Farmaci	6										6
34	Infermieri e përgjithshme	18			1			1				20
35	Mami (Infermieri)	4						1				5
36	Teknik i lartë laborator	4										4
37	Fizioterapi	4						1				5
38	Imazheri	2										2
39	Administrim publik					2						2
40	Administrim-biznes	15			2			1				18
41	Menaxhim	3										10
42	Ekonomik	5										5
43	Financë	7										7
44	Financë-kontabilitet				2			1				3
45	Turizëm (menaxhim)							1				1
46	Inxhinieri mekanike		5									5
47	Inxhinieri metalurgji materiale		2									2
48	Inxhinieri elektrike		5									5
49	Inxhinieri elektronike		5									5
50	Inxhinieri informatike		6									6
51	Inxhinieri telekomunikacioni		6									6
52	Inxhinieri mekatronike		2									2
53	Inxhinieri ndërtimi		6									6
54	Arkitekturë		7									7
55	Inxhinieri gjeodet		2									2
56	Menaxhim agrobiznesi				2							2
57	Ekonomi dhe politikë agrare				1							1
58	Mbrojtje bimësh											0
59	Hortikulturë											0
60	Prodhim bimor											0

61	Zootehni dhe biznes blegtoral											0
62	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi											0
63	Inxhinieri agromjedisi dhe ekologji											0
64	Teknologji agroushqimore											0
65	Vreshtari-enologji											0
66	Inxhinieri pyjesh			1								1
67	Inxhinieri përpunim druri											0
68	Mjekësi veterinare											0
69	Agromekanizim (Inxhinieri agrare)											0
70	Drejtësi (asistent ligjor)											0
71	Shkenca të administrimit (asistent administrativ)										11	11
72	Infermieri e përgjithshme					2					11	13
	GJITHSEJ	180	46	6	9	8		23	5	1	22	300

Tabela nr.2

KUOTAT PËR PROGRAM TË DYTË NË VITIN AKADEMIK 2010-2011

Nr.	PROGRAMI I STUDIMIT	UT	UPT	UBT	UE	UGJ	UK	USH	UV	AA	UST	UD	TROJET	TOTALI
1	Histori	1						1						2
2	Gjeografi	1						1						2
3	Histori-gjeografi						1							1
4	Gjuhë-letërsi	1						1						2
5	Gazetari	1												1
6	Gjuhë angleze	1				1	1	1						4
7	Gjuhë frënge	1						1						2
8	Gjuhë italiane	1						1						2
9	Gjuhë spanjolle	1												1
10	Gjuhë ruse	1												1
11	Gjuhë gjermane	2						1						3
12	Gjuhë greke	1												1
13	Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek					1								1
14	Gjuhë turke	1												1
15	Cikli i ulët						1							1
16	Cikli i ulët parashkollor													0
17	Fushat e veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacion										2			2
18	Edukim fizik dhe sporte				1			1						2
19	Matematikë	2						1						3
20	Fizikë							1						1
21	Biologji-kimi					1	1	1						3
22	Informatikë							1						1
23	Fizikë dhe teknologji informacioni					1								1
24	Teknologji informacioni				1	1	1							3
25	Punë sociale	1												1
26	Filozofi	1												1
27	Sociologji	1												1

28	Psikologji	1					1							2
29	Shkenca politike	1												1
30	Drejtësi	1					1				2			4
31	Skenografi-kostumografi								1					1
32	Infermieri e përgjithshme	1			1	1	1							4
33	Mami (Infermieri)	1					1							2
34	Teknik i lartë laborator	1												1
35	Fizioterapi	1					1							2
36	Imazheri	1												1
37	Administrim publik					1								1
38	Administrim-biznes				1		1							2
39	Ekonomiks	1												1
40	Financë						1							1
41	Financë-kontabilitet			1	1	1								3
42	Turizëm (menaxhim)						1							3
43	Inxhinieri mekanike		1											1
44	Inxhinieri elektrike		1											1
45	Inxhinieri elektronike		1											1
46	Inxhinieri informatike		1											1
47	Inxhinieri telekomunikacioni		1											1
48	Inxhinieri ndërtimi		1											1
49	Inxhinieri hidroteknike		1											1
50	Arkitekturë		1											1
51	Inxhinieri gjeodet		1											1
52	Inxhinieri mjedisi		1											1
53	Menaxhim agrobiznesi			1										1
54	Ekonomi dhe politikë agrare			1										1
55	Mbrojtje bimësh			1										1
56	Hortikulturë			1										1

57	Prodhim bimor			1										1
58	Zootekni dhe biznes blegtoral			1										1
59	Akuakulturë dhe menaxhim peshkimi			1										1
60	Inxhinieri agromjedisi dhe ekologji			1										1
61	Teknologji agroushqimore			1										1
62	Vreshtari-enologji			1										1
63	Inxhinieri pyjesh			1										1
64	Inxhinieri përpunim druri			1										1
65	Mjekësi veterinare			1										1
66	Agromekanizim (inxhinieri agrare)			1										1
67	Shkenca të administrimit											5		5
	GJITHSEJ	27	10	15	5	8	6	19		1	2	7		100

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 24.11.2010
Doli nga shtypi më 26.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë